



TERMAT E REFERENCËS – EKSPERT/E I/E JASHTËM PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023

Objektiva e përgjithshme

Platforma CiviKos në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar është duke kërkuar një **Ekspert/e të jashtëm për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.**

Rreth CiviKos

Platforma CiviKos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e themeluar për të krijuar dhe promovuar një mjedis të favorshëm për bashkëpunim të sektorit formal të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Kosovë.

Me një anëtarësi prej më shumë se 290 organizatash, e cila është vazhdimisht në rritje, Platforma CiviKos është e përkushtuar që të thellojë bashkëpunimin ndërmjet organizatave anëtare, si dhe autoriteteve publike dhe hisedarëve tjerë relevantë në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Bazuar në misionin e saj për të mundësuar një mjedis të përshtatshëm të shoqërisë civile në Kosovë, CiviKos do të shfrytëzojë ekspertizën dhe strukturën tashmë solide të formalizuar me institucionet publike për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm për OSHC-të.

Rreth Programit për Angazhim Qytetar

Programi për Angazhim Qytetar është një përkushtim 5-vjeçar për të kultivuar një kulturë të aktivizmit që e bën jetën nëpër lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të dashur dhe më kuptimplotë. Kjo nismë e imagjnon një të ardhme të ndërtuar në themelet e një shoqërie civile, e cila përmes aktivizmit të guximshëm, përfaqësimit nga poshtë-lart, bashkëpunimit të gjithanshëm, veprimit profesional, transparencës në të gjitha hallkat e jetës publike dhe institucionale dhe përdorimit ndryshe të burimeve sjell ndryshim rrënjësor në komunitetet tona. Po kështu, kjo nismë e synon një ndjesi të rigjetur të solidaritetit ndaj njëri-tjetrit.

Programi për Angazhim Qytetar zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë. Platforma CiviKos është partnere e KCSF në zbatimin e këtij programi.

Sfondi dhe fushëveprimi

Platforma CiviKos e lehtëson procesin e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe Qeverisë dhe bashkëkryeson Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri. [Strategjia Qeveritare për](#)

[Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023](#) i përkufizon objektivat strategjike dhe politikat që Qeveria e Republikës së Kosovës synon t'i arrijë në një periudhë afatmesme, për përmirësimin e mjedisit përkrahës në zhvillimin e shoqërisë civile si dhe krijimin e parakushteve për një bashkëpunim më efektiv me OSHC-të për reformat kryesore në vend. Kjo Strategji përbëhet nga 4 objektiva strategjike, si në vijim:

- Objektivi strategjik 1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje;
- Objektivi strategjik 2. Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik;
- Objektivi strategjik 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;
- Objektivi strategjik 4. Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik.

Për të vlerësuar implementimin e objektivave të Strategjisë, bazuar në planin e punës, Platforma CivikOs në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar është duke kërkuar një *Ekspert të jashtëm për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023*.

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij vlerësimi është që të jepet një pasqyrë e nivelit të zbatimit për secilën prej objektivave të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, bazuar në Planin e Punës të Strategjisë.

Objektivat specifike:

- Analiza e zbatimit të Strategjisë për periudhën 2019-2023;
- Analiza e zbatimit të Strategjisë bazuar në aktivitetet e përcaktuara në kuadër të objektivave strategjike të Strategjisë;
- Dhënia e rekomandimeve për veprim të mëtutjeshëm.

Metodologjia

Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë duhet të bëhet në përputhje me objektivat specifike të përcaktuara më sipër. Kontraktuesi i përzgjedhur pritet që paraprakisht të hartojë një metodologji të detajuar, të miratuar nga CivikOs. Qasja dhe metodologjia e hartuar duhet të përfshijë: metodën mikse të mbledhjes së të dhënave (sasiore dhe cilësore), mekanizmat e validimit të të dhënave etj.

- Intervista me anëtarët e Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri;
- Intervista me zyrtarë të Zyrës për Qeverisje të Mirë;
- Intervista me zyrtarë të ministrive përgjegjëse për zbatim të objektivave të Strategjisë, si: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punëve të Brendshme etj.;
- Intervista me OShC, fushëveprimi i të cilave ndërlidhet me objektivat strategjike të Strategjisë (të paktën nga 1 OShC për secilën objektivë strategjike).

Rezultatet e pritura

Raporti i vlerësimit të zbatimit të Strategjisë duhet të shkruhet në gjuhën shqipe dhe të jetë konciz në strukturën, të gjeturat dhe rekomandimet e tij.

Rezultatet/të arriturat kryesore do të përfshijnë:

- Kornizën/dizajnin e detajuar të vlerësimit dhe planin e zbatimit, të dakorduar me CiviKos;
- Mjetet e mbledhjes së të dhënave;
- Draftin e raportit të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë;
- Raportin final të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë.

Kriteret

Eksperti/ja apo kompania duhet të ketë:

- Përvojë të gjerë (së paku 5 vite) në kryerjen e detyrave të ngjashme;
- Njohuri të plotë të gjendjes politike dhe socio-ekonomike të vendit, si dhe ambientit të veprimit të sektorit joqeveritar;
- Njohuri dhe përvojë të dëshmuar në sektorin e shoqërisë civile, dhe qeverisë;
- Përvoja e punës me Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri konsiderohet përparësi;
- Profesionalizëm i lartë i dëshmuar dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në situata me presion të lartë, nën afate të ngushta kohore;
- Aftësi të shkëlqyera në hulumtim dhe shkrim të raporteve;
- Aftësi komunikimi, duke përfshirë përvojën në prezantim;
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze. Njohja e gjuhës serbe është përparësi.

Oferta dhe buxheti

Të interesuarit mund të shprehin interesin e tyre për këtë thirrje duke dërguar CV-në e tyre, dhe një përmbledhje të shkurtër të ekspertit/kompanisë në detyra të ngjashme. Në ofertë duhet të përfshihen të gjitha kostot e propozuara në Euro. Dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen në e-mailin: info@civikos.net, jo më vonë se 9 qershor 2023.

Shënim: Anëtarët e Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri nuk kanë të drejtë aplikimi në këtë thirrje.